

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI****VENDIM****Nr. 04, Datë 10.01.2020****MBI****MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“NOA ENERGY TRADE” NR. 263, SERIA FK15, NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 8, DATË 02.02.2015.**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 37 pika 2 gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1, gërma “d”; nenit 10, pikat 1 dhe 3, dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.01.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 125/1 Prot, datë 27.12.2019, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., për rinovim licence në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE nr. 727/3 Prot, datë 16.12.2019, ka aplikuar për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Kjo shoqëri është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim i Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar. Në datën 27.09.2014 është regjistruar pranë QKB, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk), konform Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L42203031A.
- Shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 263, Seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me Vendim të Bordit të ERE-s Nr. 7, datë 02.02.2015, me afat 5-vjeçar. Kjo licencë përfundon në datën 02.02.2020.

- Në nenin 16, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, parashikohet se Jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë, personi mund/duhet të kërkojë në ERE rinovimin e licencës.
- Referuar sa më sipër, afati i fundit brenda të cilit, shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., duhej të kishte aplikuar në ERE për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike ishte data 02.12.2019.
- Në nenin 10, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, përcaktohet: *Çdo aplikim do të paraqitet në përputhje me formën, përmbajtjen, afatet dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje, duke plotësuar kërkesat dhe dokumentat e kërkuara në të. Në të kundërt Bordit të ERE-s i propozohet mosfillimi i procedurave të shqyrtimit të aplikimit.*
- Nga sa konstatuar, shoqëria “NOA Trade Energy” sh.p.k., nuk ka aplikuar brenda afatit ligjor të parashikuar për rinovimin e licencës.
- Rezulton se shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k., ka kryer pagesën për aplikimin për rinovim.
- Shoqëria “NOA Trade Energy” sh.p.k., ka depozituar një dokumentacion të konsiderueshëm bashkëlidhur aplikimit të saj për rinovim të licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, por ky aplikim nuk është paraqitur në afat sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Me vendimin Nr. 215, datë 20.12.2019, të bordit të ERE janë miratuar disa shtesa dhe ndryshime në Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të cilat kanë hyrë në fuqi pas depozitimit të aplikimit të shoqërisë NOA Trade Energy, ndaj në këto kushte për shqyrtimin e këtij aplikimi është marrë për bazë legjislacioni në fuqi, në momentin e aplikimit .
- Shoqëria përmes perfaqësuesit të saj në mbledhjen e bordit të ERE, saktësoi se kërkon trajtimin si kërresë për rinovim dhe jo si aplikim për licencim, kërkesë që nuk gjendet në përputhje me rregullimet ligjore siç cituar më lart.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “NOA Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, nr. 263, Seria FK15, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, Nr. 7, datë 02.02.2015, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI